

POLITIKA E SHKOLLËS PËR EDUKIMIN PËR KARRIERËN

Një politikë shkolle për edukimin dhe orientimin për karrierën kërkohet që të tregojë:

- Të kuptuarit e nevojave të nxënësve për zhvillimin e karrierës;
- Si synon ajo të përmbushë këto nevoja;
- Si do të përmbushë ajo kërkesat ligjore/Pritshmërinë e qeverisë.

Me qëllim për të qenë efektive kurrikula e edukimit për karrierën duhet të integrohet si pjesë e dokumentacionit të politikave të shkollës.

Praktika e mirë: *Si pjesë e edukimit dhe orientimit për karrierën në shkolla të gjithë nxënësit duhet të presin:*

- Informacion, këshilla dhe orientim nga një individ i caktuar i cili do t'i fuqizojë ato dhe do t'i mundësojë të marrin pjesë në mënyrë efektive në procesin e të mësuarit, me qëllim që ato të arrijnë potencialin e tyre të plotë dhe të bëjnë progres drejt qëllimeve më afatgjatë të karrierës;
- Mundësi për të pasur një rrjet mbështetjeje për një rang të gjerë çështjesh;
- Barazi mundësish;
- Monitorim të progresit të tyre, dhe ndihmë herë pas here, si të jetë nevoja;
- Mbështetje individuale dhe në grup brenda shkollës;
- Vlerësim diagnostikues të nevojave të tyre të të mësuarit dhe të orientimit;
- Këshillim karriere të paanshëm;
- Mbështetje për progres dhe tranzicion (planifikim);
- Mbështetje kur kërkohet, duke përfshirë negocim me institucione arsimore dhe ofrues trajnimesh;
- Një kurrikul e cila zhvillon aftësitë vetë-ndihmuese.

Kurrikula e edukimit për karrierën: Kurrikula duhet të zhvillojë aftësitë dhe kuptimin e një planifikimi për karrierën dhe të arrijë kulmin kur nxënësit ndërmarrin vendime realiste dhe të mirë-informuara për të ardhmen e tyre. Mësimet duhet të jenë të hartuara në mënyrë që të zhvillojnë njohuritë dhe kuptimin e nxënësve në lidhje me botën e punës dhe mundësitë e mëtejshme të arsimit ose mundësitë për arsimin e lartë.

Fushat kyçe të politikës së edukimit për karrierën:

1. Të prodhojë një skemë pune duke marrë në konsideratë nevojat për rezultate të përshtatshme të të mësuarit dhe metodat e mësimdhënies;
2. Të zhvillojë burime për karrierën për stafin dhe nxënësit;
3. Të identifikojë modele efektive të mësimdhënies. Lënda e edukimit për karrierën mund të jepet ose nga një skuadër specialistësh ose nga mësuesit e lëndëve.

Formati i Politikës së Edukimit për Karrierën

Titulli:	Emri i institucionit Politika e edukimit dhe orientimit për karrierën
Hyrja:	Arsyetimi për edukimin dhe orientimin për karrierën Angazhimi nga shkolla Zhvillimi i një politike Lidhjet me politika të tjera të shkollës
Qëllimet:	Vetë-vlerësimi Hulumtimi i karrierës Menaxhimi i Karrierës
Objektivat:	Si planifikon shkolla të arrijë qëllimet
Implementimi:	Menaxhimi Stafi Kurrikula – plani i mësimdhënies i cili duhet të përfshijë edhe palë të tjera Partneriteti – me kë do të punojë shkolla për të dhënë këtë orë mësimore Burimet – duke përfshirë edhe buxhetin Zhvillimin e stafit Monitorimin/planet rishikuese dhe vlerësuese
Miratimi:	Firmat Datat Datat e rishikimit dhe vlerësimit